



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr.____, datë _____.2025

PËR

**MIRATIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E
VIKTIMAVE DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8920, datë 11.7.2002, “Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj”, si dhe të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore’”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 499, datë 29.8.2018 “Për miratimin e procedurave standard të veprimi për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I BRENDSHËM

ERVIN HOXHA